

L I G J
Nr.8527, datë 23.9.1999

PËR PRIVATIZIMIN E HIDROCENTRALEVE VENDORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Me hidrocentrale vendore kuptohen ato hidrocentraleve që kanë fuqi të instaluar nën 2 MW.

Neni 2

Hidrocentralet me fuqi nën 2 MW të privatizohen si objekte të veçanta. Forma e privatizimit të tyre është ankandi për transferimin e të drejtës së pronësisë, si dhe transferimi i të drejtës së zhvillimit nëpërmjet kontratave koncensionare. Procedurat e ankandit dhe të kontratave koncensionare të realizohen në përputhje me aktet normative në fuqi.

Neni 3

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga këto hidrocentrale të bëhet sipas tarifave të përcaktuara nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.

Neni 4

Të ardhurat ng shitja e këtyre objekteve të ndahen si vijon:

- 95 për qind për KESH-in, sha;
- 5 për qind për Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

Neni 5

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtre.

Shpallur me dekretin nr.2451, datë 5.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani